REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 nëntor 2016
Nr. ref.:RK995/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI32/16

Parashtrues

Ibrahim Svarça

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 221/2015, të 1 shtatorit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Ibrahim Svarça, me banim në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 221/2015, i 1 shtatorit 2015, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 24 tetor 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartpërmendur.

4. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe me nenin 13 (E drejta për Zgjidhje Efektive) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 16 shkurt 2016, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 14 mars 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 26 prill 2016, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës, si dhe i dërgoi një kopje të saj Gjykatës Supreme.

9. Më 15 shtator 2016, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër Shoqërisë Aksionare "Montazha" nga Beogradi, duke kërkuar vërtetimin e pronësisë në ngastrën kadastrale e cila është e evidentuar me numër 1504/2, në bazë të kontratës për shitblerje të 13 majit 2005.

11. Më 3 prill 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 841/2006), ka aprovuar kërkesën e parashtruesit.

12. Pas Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar në Komunën e Prishtinës - Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit (në tekstin e mëtejmë: Komuna e Prishtinës), kërkesën për regjistrimin e pronës së paluajtshme.

13. Për shkak *"të heshtjes së Administratës të Komunës së Prishtinës, lidhur me mosrealizimin e kërkesës për kryerjen e transaksionit"*, më 2 tetor 2007, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Ministrinë e Shërbimeve Publike, Agjencia Kadastrale e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Agjencia Kadastrale).

14. Më 8 tetor 2007, Agjencia Kadastrale nxjerr konkluzion (nr. 738/7) dhe *"urdhëron Zyrën Kadastrale në Prishtinë që të shqyrtojë kërkesën për regjistrim të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës dhe të nxjerr Vendim për këtë çështje administrative"*.

15. Për shkak të mosveprimit të mëtejshëm të Komunës së Prishtinës, në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Gjykatës Komunale në Prishtinë në procedurë përmbarimore ndaj debitorit, Komuna e Prishtinës, ku kërkoi regjistrimin e parcelës në emër të tij.

16. Më 8 shkurt 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktvendimi E. nr. 6/09), aprovoi kërkesën e parashtruesit. Më tej, në Aktvendim theksohet *"[...] në bazë të dokumentit përmbarues-Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë C. Nr. 841/2006 i dt.03.04.2007 është i formës së prerë më 14.05.2007 [...]. CAKTOHET PËRMBARIMI ashtu që URDHËROHET debitori Komuna e Prishtinës–Drejtoria për pronë Gjeodezi dhe kadastër që të regjistroj në librat e tokës në emër të kreditorit Ibrahim Svarça nga Prishtina, paluajtshmërinë-ngastrën kadastrale nr. 1504/2"*.

17. Më 18 mars 2011, Agjencia Kadastrale (Aktvendimi nr. 011952-2292) aprovon kërkesën e parashtruesit që ka të bëjë me të drejtën e shfrytëzimit të pronës.

18. Më 16 prill 2011, Komuna e Prishtinës i drejtohet Agjencisë Kadastrale nëpërmjet parashtresës 001-031-218, duke u arsyetuar për mosekzekutim të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale dhe duke pretenduar që në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 dhe Urdhëresës së UNMIK-ut 2006/17, Komuna kishte njoftuar Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme lidhur me rastin, duke argumentuar që çështja është dashur të gjykohej në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe jo në Gjykatën Komunale.

19. Më 16 maj 2011, Zyra Kadastrale e Komunës së Prishtinës, ka lëshuar Certifikatën mbi të drejtat pronësore në paluajtshmëri, me nr. UL-71914059-09836, në emër të parashtruesit të kërkesës.

20. Pasi parashtruesi i kërkesës kishte fituar të drejtat e plota në paluajtshmërinë në fjalë, ushtroi padi për kompensim të dëmit material në Gjykatën Komunale

në Prishtinë ndaj Komunës së Prishtinës. Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar *"që të detyrohet Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Prishtinë në emër të qerasë për pronën në ngastrën kadastrale 1504/2[...] t'ia kompenzojë për periudhën 14.05.2007 deri më 01.05.2010 shumën prej 469. 273.30 Euro si dhe për periudhën e ardhshme duke filluar prej 01.05.2010 e tutje [...]".*

21. Më 20 nëntor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 2644/08), refuzoi kërkesëpadinë si të pabazuar.

22. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, C. nr. 2644/08, të 10 nëntorit 2011, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

23. Më 3 mars 2015, Gjykata e Apelit e Kosovës (Aktgjykimi Ac. nr. 4521/12), refuzoi si të pabazuar ankesën. Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj arsyeton se gjykata e shkallës së parë ka marrë vendim të drejtë dhe të bazuar.

24. Më pas, parashtruesi i kërkesës parashtroi revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, ndaj Aktgjykimit Ac. nr. 4521/12 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

25. Më 1 shtator 2015, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi, Rev. nr. 221/2015), refuzon si të pabazuar kërkesën për revizion. Gjykata Supreme e Kosovës arsyeton *"[...] gjykatat e instancës më të ulët duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejtë kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale".*

26. Më 23 nëntor 2015, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në Prokurorinë e Shtetit.

27. Më 3 dhjetor 2015, Prokurori i Shtetit, me njoftimin KMLC. nr. 123/2015, ka refuzuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë me arsyetimin se *"ka kaluar afati ligjor për paraqitjen e këtij mjeti juridik".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 221/2015, të 9 shtatorit 2015, i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, përkatësisht me nenin 24 [Barazia para Ligjit], me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si dhe me nenin 13 (E drejta për Zgjidhje Efektive) të KEDNJ-së.

29. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata:

"Të vërtetojë se gjatë zhvillimit të kësaj procedure civile në gjykatën e shkallës së parë - Gjykatën Themelore në Prishtinë, në gjykatën e shkallës së dytë – Gjykata e Apelit në Prishtinë dhe në Gjykatën Supreme të Kosovës, kishin vendosur në dëm timin [...] duke kërkuar ANULIMIN e aktgjykimeve të 3 (tre) niveleve-instancave gjyqësore sikur të theksuara më lart".

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".

(...)

"7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

32. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 48 të Ligjit [Saktësimi i kërkesës], i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij ta qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

33. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
(...)

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

"(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
(...)

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

(...)

34. Gjykata rikujton se kontesti rreth paluajtshmërisë në fjalë është zhvilluar në dy faza. E para ka të bëjë me kërkesën e parashtruesit për regjistrimin e pronësisë në ngastrën përkatëse kadastrale në emër të tij në bazë të Aktgjykimit, C. nr. 841/2006 të Gjykatës Komunale të 3 prillit 2007, e cila kërkesë u realizua më 16 maj 2011, kur Zyra Kadastrale e Komunës së Prishtinës ka lëshuar Certifikatën mbi të drejtat pronësore në paluajtshmërinë në fjalë. Ndërsa, e dyta ka të bëjë me kërkesën për kompensim të dëmit material nga Komuna e Prishtinës në emër të qerasë së parealizuar, si pasojë e mosbartjes me kohë të patundshmërisë në librat kadastralë, procedurë kjo që u përmbyll me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 221/2015 i 1 shtatorit 2015, me të cilin ishte vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, të cilin Aktgjykim parashtruesi i kërkesës tash e konteston në Gjykatën Kushtetuese.

35. Gjykata rikujton se parashtruesi pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 221/2015, i 1 shtatorit 2015, i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, të përcaktuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si dhe me nenin 13 (E drejta për Zgjidhje Efektive) të KEDNJ-së.

36. Lidhur me pretendimin e parashtruesit për shkelje të nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], parashtruesi i kërkesës pretendon se *"nuk jam marrë në konsideratë se nga institucionet e theksuara të Republikës së Kosovës jam i dëmtuar në të drejtat e mia për ta gëzuar pronësinë dhe pronën"*.

37. Në këtë drejtim, Gjykata së pari thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit apo Gjykata Komunale në Prishtinë, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

38. Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale, si edhe të asaj materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11 të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

39. Është me rëndësi të ceket se Gjykata mund të shqyrtojë vetëm nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në atë mënyrë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, *inter alia*, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, miratuar më 10 korrik 1991).

40. Për më tepër, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme në mënyrë specifike ka adresuar dhe elaboruar pretendimet kryesore të parashtruesit lidhur me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe nëse vendimet e gjykatave më të ulëta ishin të mbështetura në fakte të provuara.

41. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, e cila konkludoi se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit ishte i qartë dhe i kuptueshëm dhe se ai përmbante arsye të mjaftueshme dhe fakte vendimtare për nxjerrjen e një vendimi të ligjshëm. Në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, ndër të tjera, theksohet:

"Kjo gjykatë konsideron se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për faktin sepse nga shkresat e lëndës rrjedh se e paditura nuk është përgjegjëse për kompensimin e dëmit të pretenduar nga paditësi, për faktin relevant se e paditura në përpjekje të zbatimit të aktgjykimit të lartpërmendur, përkatësisht, ndryshimit bartjes së paluajtshmërisë në paditësin, e nga arsyet e lartpërmendura, po thuaj suksesivisht kërkonte, në kuadër të kompetencave të veta ligjore, mendimin përkatësisht pëlqimin përkatës nga AKM-ja e cila, aktgjykimin e sipërpërmendur e konsideronte si një vendim i nxjerr nga një gjykatë jo kompetente, pra, duke konsideruar se për çështjen e pronës kontestuese do të duhej të vendoste Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, e jo ndonjë gjykatë tjetër vendore , që nuk ka juridiksion". Gjykata e Apelit e Kosovës, më tej, në Aktgjykim thekson se *"përgjegjësia për dëmin eventual të kërkuar nga paditësi, nuk mund t'i mvishet veprimit a mos veprimit të komunës së paditur, sepse në këtë 'mes' kishte ndërhyrë AKM-ja, me qëndrimet e saja të sipër shtruara dhe se e paditura, siç rezulton nga shkresat e lëndës, ishte në kërkim e sipër të pëlqimit përkatës nga AKM-ja".*

42. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se të gjitha argumentet e parashtruesit të kërkesës, të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit, gjykatat e rregullta i kishin shqyrtuar; se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin që ai kundërshton janë të paraqitura në mënyrë të detajuar dhe se, në bazë të asaj që u tha më lart, procedurat pranë gjykatave të rregullta, në përgjithësi, ishin të drejta.

43. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu pretendon se i janë shkelur neni 24 [Barazia para Ligjit] dhe neni 13 (E drejta për Zgjidhje Efektive) i KEDNJ-së. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka paraqitur ndonjë fakt dhe nuk e ka dëshmuar pretendimin për shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 24 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të paraqes një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës. (Shih rastin nr. KI198/13, parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri i 13 marsit 2014).

44. Gjykata rikujton, që fakti se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit, nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të Kushtetutës (shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

45. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur me prova e as nuk e ka arsyetuar mjaftueshëm pretendimin e tij në baza kushtetuese për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, specifikisht, për shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës si dhe nenit 13 (E drejta për Zgjidhje Efektive) të KEDNJ-së, sepse faktet e paraqitura nga ai në asnjë mënyrë nuk tregojnë që gjykatat e rregullta i kanë mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

46. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashihet me nenin 48 të Ligjit dhe siç specifikohet më tej me kriteret e pranueshmërisë, rregullat 36 (1) (d), (2) (d), të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d), (2) (d) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 15 shtator 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Gresa Caka-Nimani

Arta Rama-Hajrizi